

Nr. 2305/41 K (e-k) Prot.
Tiranë, më datë 06/05/2023

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
z. Ilirjan CELIBASHI

Lënda: **KONSTATIME** – Raporti XVI i
Gjetjeve dhe Rekomandimeve për
javën 28 prill – 4 maj 2023, lidhur
me raportimet në ndërfaqen e
raportimeve të KQZ-së të
veprimtarive me karakter publik
të institucioneve publike,
agjencive dhe/ose ndërmarrjeve
shtetërore.

I Nderuar z. Komisioner!

Të nderuar Kolegë të Administratës së KQZ-së!

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin në vazhdimësi, mund të gjeni në vijim Gjetjet dhe Rekomandimet e Raportit të monitorimit të KRIIK për javën e gjashtëmbëdhjetë të funksionimit të mekanizmit të raportimit të institucioneve në ndërfaqe, për periudhën 28 prill – 4 maj 2023.

Gjatë monitorimit të kësaj jave, KRIIK ka evidentuar disa problematika, si:

1. Raportimi i aktiviteteve me vonesë
2. Raportime ku mungojnë detajet
3. Veprimtari publike të zhvilluara, por të pa raportuara
4. Përdorimi i burimeve publike për fushatë elektorale nga Kryeministri z. Edi Rama, Zv. Kryeministrja znj. Belinda Balluku dhe Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale znj. Ogerta Manastirliu

Konkretisht:

1. RAPORTIMI I AKTIVITETEVE ME VONESË

Praktika e raportimit të aktiviteteve me vonesë vijon.

Nga monitorimi rezulton se **rreth 7.4% e raportimeve në javën e gjashtëmbëdhjetë janë me vonesë.**

Specifikisht, nga 122 aktivitete të raportuara gjatë kësaj periudhe, 9 janë raportuar me vonesë (për më shumë shih **Lidhjen 1**, e cila përmbledh të dhënat për raportimet me vonesë, si dhe **Lidhjen 2** me listën e detajuar të këtyre aktiviteteve, së bashku me të dhënat përkatëse referuar ndërfaqes së aktiviteteve në faqen e internetit të KQZ-së).

Numri total i institucioneve raportuese përgjatë periudhës kohore që mbulon ky raport është 41, nga të cilat 8 kanë raportuar së paku një aktivitet përtej afatit të përcaktuar ligjor.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Ritheksohet se këto shifra i referohen vetëm raportimeve të kryera nga institucionet në ndërfaqe dhe që mund të aksesohen aty. Nëse në KQZ kanë mbërritur raportime me anë të postës elektronike, apo me mjete të tjera të komunikimit dhe nuk janë hedhur në ndërfaqe, këto nuk përfshihen në të dhënat e mësipërme.

2. RAPORTIME KU MUNGOJNË DETAJET

Vërehet se vijon mungesa e detajeve në një numër raportimesh, detaje të cilat do të bënin të mundur që monitoruesit e KQZ-së apo të tjerë aktorë të interesuar të mund të marrin pjesë apo t'i vëzhgojnë eventet.

Gjithashtu, sikurse është konstatuar edhe nga ju si administratë, mungesa e detajeve sjell një problematikë serioze në monitorimin e aktiviteteve, veçanërisht për evidentimin e aktiviteteve të pa-raportuara. Aktivitetet e raportuara pa detaje pamundësojnë identifikimin e tyre, pasi nuk është e mundur të përcaktohet konkretisht aktiviteti.

Të tilla raste janë të shumta, por sillen si shembuj ilustrues vetëm dy prej tyre:

- “Aktivitetet për “Diten e Infermierit”” për të cilin tek fusha “**Vendi i Zhvillimit**” **plotësohet “Tiranë”**, Linku i raportimit: <https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/05/04/aktivitet-per-diten-e-infermierit/>. .
- “Java boterore e vaksinimit -Fushata HPV” për të cilin tek fusha “**Vendi i Zhvillimit**” **plotësohet “Tirane”**. Linku i raportimit: <https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/04/20/java-boterore-e-vaksinimit-fushata-hpv/>..

Në vazhdimësi të sa është kërkuar në raportet e mëparshme, është me vend që KQZ t’u tërheqë vëmendjen institucioneve raportuese në lidhje me këtë fenomen, pasi kjo mënyrë raportimi përbën së paku mos-përmbushje në mënyrën e duhur të detyrimit ligjor.

3. VEPRIMTARI PUBLIKE TË ZHVILLUARA, POR TË PA RAPORTUARA

Nga monitorimi jo sistematik i faqeve zyrtare të disa institucioneve në mediat sociale, si dhe i mediave të tjera online lidhur me pasqyrimin e aktiviteteve të tyre të mundshme, gjatë periudhës 28 prill – 4 maj 2023, rezulton se **së paku 5 veprimtari publike nuk janë raportuar në ndërfaqen e KQZ-së**. Këto veprimtari janë kryer nga 5 institucione, sipas **Lidhjes nr. 4** bashkëlidhur këtij raporti. (për më tepër gjeni bashkëlidhur **Lidhjen nr. 3** me listën e këtyre aktiviteteve së bashku me informacione shtesë të pasqyrimeve mediatike që provojnë realizimin e tyre).

Lidhur me këtë konstatim, ritheksohet se **ai bazohet në gjykimin se këto aktivitete nuk janë raportuar, pasi ato nuk pasqyrohen në informacionin e bërë publik në ndërfaqen e KQZ-së, si edhe se me shumë gjasë numri i aktiviteteve të pa raportuara është më i lartë, pasi gjetjet bazohen në një monitorim të kryer në mënyrë jo sistematike.**

Nevojitet që **KQZ-ja** nëpërmjet veprimeve institucionale dhe vendimmarrjeve të nevojshme të sigurojë dhe propagandojë **zbatimin pa ekuivok të ligjit, pa e relativizuar asnjë rast aspektin sanksionues të tij**, pavarësisht argumenteve të paraqitura.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Çdo justifikim i paraqitur, gjykohet paraprakisht **se nuk ka asnjë vlerë të merret në konsideratë me zemërgjerësi nga KQZ-ja**, tanimë kur procesi i raportimit është në javën e fundit të tij.

4. PËRDORIMI I BURIMEVE PUBLIKE PËR FUSHATË ELEKTORALE NGA KRYEMINISTRI Z. EDI RAMA, ZV. KRYEMINISTRJA ZNJ. BELINDA BALLUKU DHE MINISTRJA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE ZNJ. OGERTA MANASTIRLIU

Më datë 03.05.2023 Kryeministri z. Edi Rama, Zv. Kryeministrja dhe Ministrja e Energjisë dhe Infrastrukturës, njëkohësisht Drejtuese Politike e Qarkut të Dibrës e Partisë Socialiste znj. Belinda Balluku dhe Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale znj. Ogerta Manastirliu kanë zhvilluar një takim me mjekët dhe infermierët e Klosit dhe Matit.

KRIIK nuk ka arritur të gjejë në ndërfaqen e raportimeve një njoftim për këtë aktivitet, pra figuron të jetë **i pa raportuar, nga asnjë prej institucioneve drejtuesit e të cilave ishin në takim.**

Njoftimi për zhvillimin e kësaj veprimtarie është postuar në profilin zyrtar të Kryeministrit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe dhe Mbrojtjes Sociale , si dhe të dy ministreve.

Konkretisht:

Postimi në faqen e [Kryeministrit Z. Edi Rama](#) (më poshtë përmbajtja dhe foto/printscreens e faqes):

“Me mjekët dhe infermierët e Klosit dhe Matit për të bashkëbiseduar për planin 2-vjeçar të rritjes së pagave që ka filluar të jetësohet dhe përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore, për t'i krijuar stafeve mjekësore mundësinë për ta ushtruar me dinjitet profesionin e tyre fisnik”

[#VetëmPërpara](#)
[#KurrëMëMbrapa](#)



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:


P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Postimi video në faqen e **Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** (më poshtë përmbajtja dhe foto/printscreens e faqes):

Me mjekët dhe infermierët e Klosit dhe Matit për të bashkëbiseduar për planin 2-vjeçar të rritjes së pagave që ka filluar të jetësohet dhe përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore, për t'i krijuar stafeve mjekësore mundësinë për ta ushtruar me dinjitet profesionin e tyre fisnik

[#VetëmPërpara](#)

[#KurrëMëMbrapa](#)



Postimi foto në faqen e **Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** (më poshtë përmbajtja dhe foto/printscreens e faqes):

Sot takova zonjat profesioniste mjekë dhe infermiere të qendrës shëndetësore [#Klos](#) dhe stafin e mrekullueshëm të qendrave shëndetësore dhe spitalit të Matit, të cilët bëjnë një punë të jashtëzakonshme për t'i shërbyer me cilësi qytetarëve.


Me Kryeministrin Edi Rama dhe Zv/Kryeministren Belinda Balluku ndamë me mjekët dhe infermierët lajmin e mirë të rritjes së pagave me planin 2-vjeçar që fuqizon burimet tona njerëzore ✓

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



Postimi në [faqen e Zv. Kryeministres](#) dhe Ministres së Energjisë dhe Infrastrukturës, znj. Belinda Balluku (më poshtë përmbajtja dhe foto/printscren e faqes):

Me mjekët dhe infermierët e Klosit dhe Matit

👩‍⚕️👨‍⚕️ *Me mjekët dhe infermierët e Klosit dhe Matit për të bashkëbiseduar për planin 2-vjeçar të rritjes së pagave që ka filluar të jetësohet dhe përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore, për t'i krijuar stafeve mjekësore mundësinë për ta ushtruar me dinjitet profesionin e tyre fisnik 🇹🇷🇷🇸🇷🇪*

[#VetëmPërpara](#)

[#KurrëMëMbrapa](#)



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Gjithashtu zhvillimi i takimit është njoftuar edhe në **Faqen Zyrtare të Internetit të [Institucionit të Kryeministresë](#)** (më poshtë tituli i artikullit dhe foto/printscren e faqes):

“Klos, me mjekë dhe infermierë të përkushtuar të zonës për planin 2-vjeçar të rritjes së pagave dhe përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore” ,



Mjekë dhe infermierë të Klosit, që kanë shërbyer për vite më radhë me përkushtim dhe profesionalizëm në këtë zonë, por në mënyrë të veçantë kanë spikatur me kontributin e tyre në periudhën e pandemisë, - ishin sot së bashku me Kryeministrin Edi Rama në një bashkëbisedim për planin 2-vjeçar të rritjes së pagave që ka filluar të jetësohet dhe përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore, për t'i krijuar stafëve mjekësorë mundësinë për ta ushtruar me dinjitet profesionin e tyre fisnik.

Është njoftuar edhe në **Faqen Zyrtare të Internetit të [Institucionit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale](#)** (më poshtë tituli i artikullit dhe foto/printscreen e faqes):

“Rama-Manastirliu: Për mjekët e familjes rritje page me 20 mijë lekë dhe infermierët me 15 mijë lekë brenda 2024”.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Rama-Manastirliu: Për mjekët e familjes rritje page me 20 mijë lekë dhe infermierët me 15 mijë lekë brenda 2024

A+ A-

f t g+



Klos, 3 maj - Kryeministri Edi Rama, bashkë me Zv.Kryeministren Belinda Balluku, Ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ogerta Manastirliu kanë zhvilluar një takim me mjekët dhe infermierët e Klosit dhe Matit, ku kanë bërë me dije edhe rritjen e targetuar të pagave për mjekët e familjes me 20 mijë lekë dhe infermierët me 15 mijë lekë, deri në vitin 2024.

Ky takim është transmetuar LIVE edhe nga media disa media, si psh: Klan Neës (më poshtë foto/video shoot):

**Address:**

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Referuar postimeve në faqet zyrtare në Facebook, ku videot janë LIVE, por edhe transmetimit LIVE në media, data e zhvillimit të aktivitetit është data 03.05.2023 në orën 12.00.

Në takim kanë qenë prezentë mjekë dhe infermierë të veshur me përparësen e bardhë. Gjithashtu në takim ka qenë edhe kandidatja e Partisë Socialiste për Kryetare në Bashkinë Klos znj. Valbona Kola, e cila në profesion është mjekë.

Në postimet e këtij aktiviteti në Facebook nga Kryeministri, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Shëndetësisë dhe Zv. Kryeministrja janë vendosur sloganet elektorale të Partisë Socialiste: [#VetëmPërpara](#) [#KurrëMëMbrapa](#)

Nga fjalimet e Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe të Kryeministrit, në takim bëhet një paraqitjeve e arritjeve të qeverisë sidomos në fushën e shëndetësisë, me një fokus të veçantë në rritjen e pagave (Fjalimet i gjeni të transkriptuara në *lidhjen nr. 5 bashkëlidhur*).

Evidentohet se Ministria e Shëndetësisë, në fund të fjalimit të saj është shprehur: “... Në fund dua të falënderoj nga zemra të gjithë ju, por veçanërisht doktoreshë Valbonën, e cila për 36 vite, së bashku me të gjithë ju këtu, ka ofruar kujdes shëndetësor për banorët e Klosit dhe tani do të marrë një stafetë të re për një mision të ri në shërbim të qytetarëve. Jo vetëm për sistemin shëndetësor por jam e bindur që një herë mjek e je gjithmonë mjek, nuk mund ta lësh këtë mision tëndin, por në shërbim të qytetarëve jam e bindur që do të bëjë akoma më shumë për Klosin që duam.”

Në gjykimin e KRIIK, aktiviteti, **pavarësisht nëse është institucional apo në kuadër të fushatës zgjedhore, përbën përdorim të burimeve publike dhe autoritetit shtetëror në funksion të fushatës elektorale të Partisë Socialiste.**

Kodi Zgjedhor në nenin 81 pika 3 jep kuptimin e një veprimtarie elektorale përgjatë fushatës zgjedhore, e konkretisht: “Veprimtaria ndjek qëllime elektorale kur ajo synon promovimin e arritjeve institucionale, të investimeve, inaugurimeve ose ecurinë në ndërtimin e punëve publike ose kur promovon aspekte specifike të programit elektorale të subjektit zgjedhor”.

Ndërsa në nenin 91 pika 1 dhe 2, Kodi Zgjedhor përcakton se:

“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, **nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.**

2. Në kuptim të këtij neni, **“burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim”.

Lidhur me gjithë sa më sipër, edhe nëse kjo veprimtari do të pretendohet e konsiderohet si:

(A) një takim me natyrë elektorale, atëherë evidentohen më poshtë këto shkelje:

1. Aktiviteti është kryer qartas gjatë orarit zyrtar të punës.
2. Pjesëmarrësit në të janë mjekë dhe infermierë të cilët do duhet të ishin në punë.
3. Pjesëmarrja e tyre është e organizuar dhe e detyruar.
4. Mjekët dhe infermierët janë të veshur me përparësen e bardhë, çka tregon prezencë në funksion të pozicionit të tyre dhe jo si qytetarë të thjeshtë.
5. Aktiviteti mund të jetë kryer në ambientet e institucionit publik, por për këtë KQZ-ja lipset të marrë informacion nëpërmjet monitoruesit të saj të fushatës zgjedhore në bashkinë ku është organizuar aktiviteti.
6. Përfaqësuesit e lartë politikë janë aty në abuzim të ofiqit zyrtar që kanë.
7. Përdorimi i sloganëve elektorale të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare Institucionale, të Institucioneve dhe Titullarëve të tyre, duke shpërdoruar kështu burimet shtetërore dhe autoritetin shtetëror.

Bazuar në sa më sipër, në gjykimin e KRIIK, aktiviteti objekt denoncimi është zhvilluar në shkelje të qartë të kuadrit ligjor dhe si i tillë, **KQZ-ja nevojitet të sanksionojë titullarët e Spitalit të Klosit, titullarët e Institucioneve Qëndrore, si dhe subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, e cila është përfituesja kryesore nga ky aktivitet.**

(B) si i karakterit institucional, atëherë evidentohen më poshtë këto shkelje:

1. Aktiviteti është i pa raportuar në ndërfaqen e KQZ.
2. Aktiviteti ka ndjekur qëllime elektorale prej Drejtuesve të Institucioneve Qëndrore, pasi zhvillohet përgjatë periudhës së fushatës zgjedhore. (“*Veprimtaria ndjek qëllime elektorale kur ajo synon promovimin e arritjeve institucionale, të investimeve, inaugurimeve ose ecurinë në ndërtimin e punëve publike ose kur promovon aspekte specifike të programit elektorale të subjektit zgjedhor*”)
3. Prania e Zv. Kryeministres dhe Ministres së Energjisë dhe Infrastrukturës, njëkohësisht Drejtuese Politike e Qarkut të Dibrës e Partisë Socialiste znj. Belinda Balluku nuk ka asnjë lidhje me natyrën e aktivitetit.
Ndaj pjesëmarrja e saj evidentohet qartazi që është në funksion të pozicionit të saj si Drejtuese Politike e Partisë Socialiste duke i dhënë aktivitetit natyrë politike e elektorale.
4. Prania e kandidatës së Partisë Socialiste për Kryetare të Bashkisë Klos znj. Valbona Kola i jep aktivitetit natyrë elektorale.
5. Fjalimi i Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (si më sipër cituar) përbën përdorim të aktivitetit publik institucional, si dhe vendosje të institucionit që ajo përfaqëson, por edhe të institucioneve të tjera të përfaqësuara aty nga titullarët respektivë, në funksion të fushatës elektorale Kandidates për Kryetare Bashkie si dhe të Subjektit Zgjedhor “Partia Socialiste”.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

6. Përdorimi i sloganëve elektoralë të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare Institucionale, të Institucioneve dhe Titullarëve të tyre, jo vetëm përbën shpërdorim të burimeve dhe autoritetit shtetëror, por evidenton natyrën elektorale të aktivitetit institucional.

Referuar gjithë sa më sipër, në çdo rast të çfarëdo pretendimi të ngritur dhe të marrjes apo jo në konsideratë prej KQZ-së, në gjykimin e KRIIK, aktiviteti objekt denoncimi është zhvilluar në shkelje të kuadrit ligjor dhe si i tillë, **nevojitet që KQZ-ja të sanksionojë titullarët e Spitalit të Klosit, titullarët e institucioneve të përfshira, si dhe Subjektin Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, e cila është përfituesja kryesore nga ky aktivitet.**

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

Me konsideratë,

***Për Koalicionin Për Reforma, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)***

**Premto Gogo
Kryetar**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania